Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

UNITED NATIONS
ALBANIA

U N
D P

Nr 3562/2 Prot
Dt 05.08.2025

# PLANI SOCIAL
# 2025-2027

## BASHKIA TROPOJË

**PERMBAJTJA**

_Toc152049526

HYRJE ..... 3
METODOLOGJIA ..... 3
LEGJISLACIONI ..... 5
1. ANALIZA E GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE ..... 8
1. 1 Vështrim i përgjithshëm ..... 8
1.2.1 Familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme ..... 9
1.2.2 Persona me aftësi të kufizuara ..... 12
1.2.3 Viktima të dhunës në familje ..... 14
1.2.4 Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje ..... 15
1.2.5 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale ..... 16
1.2.6 Personat me varësi nga droga dhe alkooli ..... 16
2. KAPACITETET E BASHKISË ..... 17
2.1 Burimet njerëzore ..... 17
Sfidat e identifikuara ..... 18
2.2 Fondi Social ..... 19
3. ANALIZA SWOT ..... 19
4. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE ..... 20
4.1 Misioni ..... 20
4.2 Vizioni ..... 20
4.3 Parimet udhërrëfyese ..... 20
5. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ..... 21
6. PLANI I VEPRIMIT ..... 34
7. MONITORIMI DHE VLERËSIMI ..... 53
8. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT ..... 53
9. SHTOJCAT ..... 54
9.1 REFERENCAT ..... 54
9.2 Buxheti ..... 56

## HYRJE

Nisur nga detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe nga nevoja reale për të ngritur një sistem komunitar shërbimesh kujdesi shoqëror për t'ju përgjigjur nevojave për mbrojtje e përkujdesje të pjesëve të ndryshme të popullsisë në territorin e saj, Bashkia Tropojë ndërmorri në periudhën korrik-nëntor 2023 procesin e planifikimit strategjik për shërbimet e kujdesit shoqëror. Në këtë proces kjo Bashki dhe grupi i saj lokal u mbështetën nga programi "Leave No One Behind 2" i Kombeve të Bashkuara, mbështetje që synoi përgatitjen e këtij plani, dhe nxitjen e stafeve të Bashkisë për të zhvilluar procese të ngjashme edhe në të ardhmen.

Përgjatë procesit grupi lokal, i mbështetur nga konsulenti kombëtar i angazhuar nga UNDP, u angazhua për të identifikuar grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Duke ndjekur një qasje ndërsektoriale grupi lokal përcaktoi prioritetet për periudhën 2025-2027 mbi të cilën u ngrit edhe plani i veprimit.

Në kushtet e mungesës aktuale të shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë, Plani Social i Bashkisë Tropojë për periudhën 2025-2027 synon të krijojë një bazë të rëndësishme për një sistem komunitar reagues ndaj nevojave të grupeve vulnerabël në territorin e saj përmes krijimit të shërbimeve sociale bazë, si dhe të përfshijë në këto shërbime çdo individ që i ka të nevojshme ato.

## METODOLOGJIA

Plani u përgatit në periudhën korrik-nëntor 2023 dhe përgjatë procesit u përdorën disa teknika të kombinuara:

1. ***U analizua legjislacioni dhe strategjitë kombëtare.*** Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror e kanë rrënjën e tyre tek politikat dhe standartet kombëtare. Analiza e legjislacionit kombëtar ndihmoi në tre drejtime kryesore: (i) listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Paketa ligjore e analizuar ka përkufizuar grupet në nevojë për shërbime. Mbi bazën e tyre u ndërtua më pas kërkimi përmes treguesve socialë dhe administrativë, si dhe konsultimeve të zhvilluara për të identifikuar se cilat janë grupet në nevojë për shërbime, si dhe karakteristikat e tyre; (ii) shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Analiza ndihmoi për të identifikuar tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe standartet specifike të tyre. Analiza lehtësoi vlerësimin e shërbimeve egzistuese, sikurse dhe planifikimin e shërbimeve që duhet të ngrihen në territorin e Bashkisë; (iii) strukturat dhe organizimi i Bashkisë në të dy nivelet e saj. Analiza e legjislacionit në këtë këndvështrim është udhërrëfyese për të rishikuar në përputhje me kuadrin ligjor rolet dhe funksionet e

Bashkisë në këtë fushë, si dhe burimet njerëzore që duhet të planifikojë për të përmbushur cilësisht këto role e përgjegjësi që i ka dhënë legjislacioni kombëtar.

2. ***U konsultua Plani Social 2024-2026***. U synua identifikimi veçanërisht i sfidave të ndeshura në zbatimin e Planit, si dhe niveli i përmbushjes së objektivave të tij dhe masave të parashikuara nga ky Plan. Grupi i punës thekson së asnjë komponent i mëparshëm i atij Plani nuk është zbatuar. Mungesa e burimeve financiare ishte faktori kryesor, por jo i vetmi. Plani i periudhës 2024-2027 ka mbajtur në konsideratë këtë realitet.

3. ***U konsultuan gjithashtu Raporte dhe Udhërrëfyes*** të hartuara në kuadrin e zbatimit të Programeve të UNDP, specifikisht: "Fondi Social – një realitet mes sfidash lokale" dhe "Kujdesi social në bashki – Mundësitë dhe Sfidat për ngritjen e strukturave[1], si dhe "Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror[2]"

4. ***Treguesit socialë dhe administrativë***. U identifikuan dhe u mblodhën përmes pyetësorëve disa tregues socialë dhe administrativë, të cilat lehtësuan identifikimin e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, karakeristikat e tyre, madhësinë, territorin ku ata jetojnë, si dhe shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë. Pas përcaktimit të instrumentave nga konsulenti kombëtar ekipi lokal punoi për mbledhjen e të dhënave nga institucionet lokale e rajonale, si dhe ndërveproi me këto institucione për mundësimin e konsultimeve të zhvilluara. Të dhënat u mblodhën në periudhën qershor-nëntor 2023. Në procesin e mbledhjes së të dhënave reagoi një numër shumë i vogël i strukturave lokale. Specifikisht të dhëna u sollën nga policia, strehimi, dy njësi administrative, Zyra e Punës, koordinatorja për masa kundër dhunës në familje dhe PMF.

5. ***Konsultime me aktorë publik, organizata dhe ofrues shërbimesh***. U zhvilluan dy tryeza konsultimesh me aktorët publik dhe jopublik lokal e rajonalë me role e përgjegjësi specifike në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (16 pjesëmarrës në tryezën e parë dhe 6 pjesëmarrës në tryezën e dytë).

6. ***Drafti i Planit Social u konsultuan me*** (1) në format elektronik u dërgua nga Shefja e Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social të Bashkisë tek të gjitha institucionet publike, organizatat në nivel Bashkie dhe Qarku; (2) U organizua një tryezë konsultimi ku morrën pjesë 16 përfaqësues të institucioneve lokale Bashki, shëndetësi, Zyra e Punës, arsim, organizata "Integrimi, si dhe zv.Kryetarja e Bashkisë. (3) Plani u Konsultua në një dëgjesë ku morrën pjesë 15 përfaqësues të grupeve në nevojë (nga të gjitha grupet e identifikuara në nevojë përgjatë hartimit të planit).

---

[1] Raporte te hartuara nga HDPC me mbështetjen e UNICEF në kuadrin e projektit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri "Asnjë të mos mbetet jashtë" mbështetur nga SDC.

[2] Hartuar nga ESA Consulting në kuadrin e programit "Mbështetje për planifikimin, buxhetimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivel vendor", pjesë e Programit Leave No One Behind, të zbatuar nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim

7. ***Kufizime:*** Pavarësisht nga përpjekjet për të identifikuar të gjitha grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, vlerësojmë se Plani ka kufizime që rrjedhin nga: (i) Niveli i ulët i përfshirjes në proces i institucioneve brenda dhe jashtë Bashkisë Tropojë. (ii) Mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë, që edhe pse përfaqësuesit e institucioneve i cilësuan si grupe në nevojë për shërbime, nuk rregjistrohen të dhëna për ta. Të tilla janë përdoruesit e drogës, personat me varësi nga alkooli, si dhe grupi i të moshuarve në nevojë për shërbime, për të cilët në të gjitha konsultimet u vlerësua se madhësia e grupit po rritet vit pas viti; (iii) Mungesa e qasjes së strukturave të shërbimit social të Bashkisë për ti identifikuar individët në nevojë drejtpërdrejtë në terren dhe jo thjesht kur ata që kanë nevojë për shërbime të drejtohen vetë tek strukturat vendore. Analiza tregoi se Bashkia nuk ka numrin e mjaftueshëm të personelit që të mund të identifikojë përmes qasjes proaktive individët në nevojë për shërbime; (iii) Pavarësisht përpjekjes për të sjellë të dhëna të disagreguara sipas gjinisë në çdo grup të identifikuar në nevojë, për shumicën e treguesve të mbledhur mungojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë.

## LEGJISLACIONI

Plani Social Lokal u hartua duke patur si udhërrëfyes nga njëra anë legjislacionin, strategjitë dhe standartet kombëtare të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe nga ana tjetër prioritetet e përcaktuara nga Bashkia për të adresuar cilësisht nevojat në ndryshim të komunitetit vendor për këto shërbime.

U analizua kuadri strategjik kombëtar duke u fokusuar tek ato strategji kombëtare që kanë në fokus target grupet që kanë të nevojshëm shërbime të kujdesit social. Në mënyrë të veçantë u analizuan: Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030; Strategjia e Përfshirjes Sociale; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore; Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve; Strategjia për Punësim dhe Aftësim; si dhe Strategjia për Strehimin Social. Secila nga strategjitë e analizuara është mbajtur në konsideratë në hartimin e këtij Plani, në këndvështrimin e përmbushjes së objektivave të tyre në kushtet lokale, si dhe të përfshirjes në Plan për zbatim të atyre masave dhe veprimeve konkrete që ngarkojnë me përgjegjësi strukturat e njësive të qeverisjes vendore. Padyshim që "Strategjia Kombëtare për Mbrojten Sociale 2024-2030", me dy prioritetet strategjike që përcakton, mban peshën kryesore në konceptimin dhe drejtimin e përgatitjes së këtij Plani. Specifikisht, (i) Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të përgjegjshme gjinore, transparente për fuqizim dhe integrim, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave; dhe (ii) Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore si dhe avancimi i deinstitucionalizimit, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë; përbëjnë edhe shtyllat thelbësore mbi të cilat ngrihet ky plan.

**Analiza e legjislacionit kombëtar[3] ishte thelbësore për të mundësuar analizën e situatës në kushtet lokale në katër drejtime kryesore:**

[3] *Në shtojcë "Referenca" gjeni të plotë Strategjitë, Legjislacionin dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave të analizuara në funksion të përgatitjes së këtij Plani Social.*

(1) **Listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë** për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë: Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në nenin 6 të tij ka përcaktuar qartësisht përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke lehtësuar kështu listimin paraprak të grupeve të mundshme në nevojë për shërbime. Metodat e ndjekura më pas gjatë procesit të përgatitjes së këtij Plani mundësuan konkretizimin për këtë Bashki të çdo grupi në nevojë për shërbime, karakteristikat dhe madhësinë e tyre, si dhe shtrirjen e tyre në territor.

(2) **Analiza e shërbimeve egzistuese dhe planifikimi i shërbimeve të reja**: Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" kanë përcaktuar qartësisht të gjitha format e shërbimeve të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat e grupeve të ndryshme në nevojë për shërbime. Ndërkohë për çdo formë shërbimi është formuluar e miratuar standarti kombëtar i shërbimit, prandaj analiza e Vendimeve të Këshillit të Ministrave apo Udhëzimeve të Ministrit përgjegjës për shërbimet shoqërore me të cilat janë miratuar këto standarte ishte gjithashtu e rëndësishme në funksion të përgatitjes së planit, pasi përmes tyre : (i) u identifikuan tipet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe standardet specifike të tyre; (ii) u mundësua vlerësimi i shërbimeve egzistuese, sikurse dhe u lehtësua procesi i planifikimit të shërbimeve që duhet të ngrihen në territorin e Bashkisë;

(3) **Analiza e strukturave, organizimit të Bashkisë në të dy nivelet e saj, si dhe kapacitetet financiare**. Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", si dhe Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" kanë përcaktuar qartësisht funksionet e Bashkive në fushën e shërbimeve sociale. Për ti përmbushur funksionet e tyre ligjore Bashkitë duhet të kenë burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme. Analiza e ligjeve, "Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara", Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Ligji 22/2018 "Për strehimin social", Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligji "Për barazinë gjinore, ndihmoi procesin e analizës dhe planifikimit në dy komponentë të rëndësishëm:

(i) ***organizimi i Bashkisë dhe burimet njerëzore.*** Dy janë strukturat që Bashkia duhet të ndërtojë me qëllim funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social në Bashki, e cila në thelb duhet të planifikojë, ndërtojë e të garantojë funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve shoqërore. Përveç


United Nations Development Programme
United Nations House
"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

funksioneve të drejtpërdrejta të mbrojtjes sociale (pagesat në para për familjet me ndihmë ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara) dhe planifikimit e ngritjes së shërbimeve shoqërore, kjo strukturë duhet të përmbushi funksione që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve ( përmes Njësisë së Mbrojtjes së fëmijës), të masave kundër dhunës me bazë gjinore (përmes Koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje), adresimin e çështjeve gjinore (koordinatori gjinor) dhe përfshirjes sociale (nëpunësi për aksesueshmërinë). Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit janë struktura që në përputhje me ligjin 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit shoqëror" duhet të përmbushin funksionet e identifikimit, menaxhimit dhe referimit në shërbime të individëve në nevojë për shërbime. Kjo strukturë, sipas nenin 36 të këtij ligji, duhet të ngrihet në nivelin e njësisë administrative dhe duhet të ketë në përbërje aministratorin shoqëror (në zbatim të ligjit për asistencën sociale), punonjësin social (një punonjës social për 6.000 deri në 10.000 banorë) dhe punonjësin e mbrojtjes së fëmijës (sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës për çdo 3.000 fëmijë duhet të ketë një PMF).

(ii) ***kapacitetet financiare***. Ligji 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit shoqëror" dhe pika 2 e VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social", përcaktojnë se çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në tërësi analiza e legjislacionit për të dykomponentet: burime njerëzore e financiare të Bashkisë mundësoi identifikimin e kapaciteteve egzistuese të Bashkisë duke mbajtur referencë parashikimet kombëtare e për rrjedhojë udhëhoqi planifikimin e masave që duhet të përfshihen në plan për të adresuar problematikat egzistuese.

(4) **Analiza e nderveprimit multisektorial dhe ndërinstitucional.** Bashkia me strukturat e saj përgjegjëse nuk është i vetmi institucion që ka role e përgjegjësi specifike që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar për të adresuar nevojat e grupeve vulnerabël në territorin e saj. Një numër institucionesh publike në nivel lokal e rajonal kanë përgjegjësi specifike për grupe specifike. Ndërveprimi i masave dhe punës së të gjitha këtyre institucioneve është thelbësor për të adresuar cilësisht nevojat e individëve në nevojë për shërbime shoqërore. Detyrimin për ndërveprim e gjejmë jo vetëm në kuadrin ligjor, por veçanërisht në aktet nënligjore që kanë përcaktuar qartësisht se çfarë masash/ndërhyrjesh merren nga çdo institucion në situata specifike që synojnë mbrojtjen dhe

përkujdesin ndaj individëve të ndryshëm në situatë të vështirë. Të tilla janë vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë përcaktuar rregullat e bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për: fuqizimin ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, mbrojtjen e fëmijëve, masat kundër dhunës në familje, për viktimat e trafikimit, të moshuarit etj. Analiza e këtyre akteve nënligjore mundësoi jo vetëm analizën e gjendjes egzistuese të reagimit ndërinstitucional, por edhe planifikimin e masave që duheshin përfshirë në këtë plan me qëllim adresimin e problematikave të identifikuara.

## 1. ANALIZA E GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EGZISTUESE

### 1. 1 Vështrim i përgjithshëm




Bashkia Tropojë përbëhet nga tetë njësi administrative. Në përbërje të kësaj Bashkie janë dy qytete (Bajram Curri dhe Fierzë) dhe 68 fshatra.

Të dhënat e censusit 2011[4] japin një numër popullsie prej 20.517 banorësh. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të vitit 2019 në këtë Bashki janë të rregjistruar 28,157 banorë, pjesë e 9,473 familjeve. Nëse e krahasojmë me të dhënat e Censusit 2011, rezulton se 73% e popullsisë së rregjistruar në gjendjen civile banojnë fizikisht në territorin e Bashkisë Tropojë. Siç shihet dhe nga grafiku, sipas gjendjes civile 30% e popullsisë janë të rregjistruar në njësinë administrative Bajram Curri, 20% e popullsisë është e rregjistruar në njësinë administrative Tropojë, 11% në njësinë administrative Margegaj dhe në katër njësitë e tjera administrative përqindja e popullsisë lëviz nga 6%-8,5%. Duke ju referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe të familjeve, konkludojmë se numri mesatar i pjesëtarëve për familje është 3.

Duke ju referuar grup moshave të dhënat flasin për : (i) 6,598 fëmijë të moshës 0-18 vjeç (24% e popullsisë); (ii) 18,418 persona të moshës 19-64 vjeç (65% e popullsisë); 3,141 persona me moshë mbi 65 vjeç (11 % e popullsisë).

[4] Aksesuar në http://zgjedhje2015.reporter.al/ëp-content/uploads/2015/05/Bashkia-Tropoje.pdf

Pavarësisht përpjekjes për të identifikuar madhësinë numerike dhe shtrirjen e saktë në çdo njësi administrative të grupeve në nevojë për shërbime sociale, mungesa e të dhënave nga institucione të ndryshme si brenda edhe jashtë Bashkisë gjatë periudhës së përgatitjes së Planit Social e bëri këtë përpjekje të pamundur. Peshën kryesore në analizën në vijim e mbajnë konkluzionet e diskutimeve në tryezat ndërsektoriale të zhvilluara në funksion të përgatitjes së këtij Plani Social.

Në vijim prezantohen gjetjet për situatën e grupeve të identifikuara në nevojë. Tërësisht i saktë mbetet fakti që edhe pse kishte një Plan Social të miratuar, Bashkia Tropojë nuk e ka zbatuar atë për arsye të mungesës së fondeve. Për rrjedhojë në këtë Bashki vijon të mos egzistojë asnjë formë shërbimi kujdesi shoqëror, pavarësisht nevojave në rritje të grupeve vulnerabël në territorin e saj.

### 1.2.1 Familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme

#### Madhësia e grupit dhe karakteristika të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

Varfëria vijon të persistojë në Bashkinë Tropojë. Të dhënat e Bashkisë për familjet përfituese të ndihmës ekonomike në korrik 2024 japin 1,499 familje përfituese të ndihmës ekonomike, ndërkohë 180 familje trajtohen nga fondi 6%. Të dhënat e muajit shtator 2019 japin 1,646 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Tropojë. Numri më i lartë i aplikuesve për ndihmë ekonomike në vitet e analizuara është në njësitë administrative Tropojë dhe Bajram Curri. Në vitin 2018 niveli i përfshirjes së familjeve aplikuese në skemën e ndihmës ekonomike ishte 79%, në vitin 2020 dhe 2024 ka shënuar rritje, pasi tashmë 92% e familjeve aplikuese në këtë Bashki përfitojnë ndihmën ekonomike.

Duke ju referuar të dhënave të gjendjes civile mbi numrin e familjeve në territorin e çdo njësie administrative, si dhe të dhënave të sektorit të ndihmës ekonomike dhe PAK mbi numrin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në secilën prej tyre konkludojmë se në nivel Bashkie 18% e familjeve në Bashkinë Tropojë janë të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike (nga skema kombëtare dhe përfitues nga 6%). Megjithatë në kushtet që numri i familjeve që jetojnë fizikisht në territor është më i ulët se ai i rregjistrit të gjendjes civile, përqindja e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike kundrejt pjesës tjetër të popullsisë është më e lartë.




Familjet më të varfëra janë ato me më shumë anëtarë dhe me fëmijë. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është 4,1 që është më e lartë se numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve në Bashkinë Tropojë.

31% e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë fëmijë (0-18 vjeç). Në moshë aktive pune janë 66% e pjesëtarëve të familjeve dhe 3% kanë moshë mbi 60 vjeç.

14% të familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike kanë grua kryefamiljare.

16% e familjeve përfituese kanë të paktën një person me aftësi të kufizuara në përbërje të tyre.

Familjet rome përbëjnë 0,9% (17 familje) të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe ato banojnë në territorin e njësisë administrative Bajram Curri.

Masa e ndihmës është e pamjaftueshme për të siguruar nevojat bazë të jetesës për familjet e varfëra. Programi i pagesave cash nuk mund të mundësojë daljen nga varfëria të familjeve më të varfëra, por duhet të kombinohet me shërbime specifike fuqizuese, rintegruese, pjesë e shportës së shërbimeve komunitare.

**Shërbimet egzistuese për individët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike**

***Fuqizimi ekonomik përmes punësimit***

Për të analizuar situatën në lidhje me nivelin e papunësisë dhe karakteristikat e punëkërkuesve në Bashkinë Tropojë u përdorën të dhëna nga Zyra e Punës për dy vite: 2019 dhe 2023.

| Viti | ToT Punëkërkues | F | M | PAK | Gra kryefamiljare | Romë | Emigrantë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2019 | 1089 | 512 | 577 | 10 | 99 | 46 | 69 |
| 2023 | 1099 | 612 | 487 | 10 | 480 | 32 | 10 |

*Në vitin 2019:*

Rezultonin 1,089 punëkërkues të papunë në tetor 2019 të rregjistruar në Zyrat e Punës. 73% e tyre jetonin në njësinë administrative Bajram Curri. Niveli më i lartë i punëkërkuesve shënohej tek meshkujt: 47% e punëkërkuesve femra dhe 53% meshkuj. 9% e totalit të punëkërkuesve ishin gra kryefamiljare. Kishte nivel absolutisht të ulët të rregjistrimit për punë të personave me aftësi të kufizuara: 0,9% e punëkërkuesve janë me aftësi të kufizuara. Individë punëkërkues të familjeve të kthyera nga emigracioni zinin 6,3% të punëkërkuesve, ndërsa romë/egjiptianë të rregjistruar në Zyrën e punës përbënin 4,2% të punëkërkuesve. 57% e punëkërkuesve të papunë kishin moshë mbi 40 vjeç.

Për numrin e përgjithshëm të popullsisë prej 28,157 banorë, rezultonte se 3,9% ishin punëkërkues të papunë.

***Në vitin 2024:***

3,9% e popullsisë të Bashkisë Tropojë janë të rregjistruar në kërkim të një pune në Zyrën e Punës.

49% e punëkërkuesve të papunë i përkasin familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Shërbimet fuqizuese dhe riintegruese për ta duhet të konsiderohen prioritare.

Rezultojnë 1,099 punëkërkues të rregjistruar në Zyrën e Punës. 56% e tyre janë femra. Pra ka një rritje me 19,5% të numrit të femrave të rregjistruar për punë krahasuar me vitin 2024.

39% e punëkërkuesve të papunë nuk kanë arsim ose kanë arsim fillor. 51% kanë arsim të mesëm të përgjithshëm dhe 10% arsim profesional ose të lartë.

Kërkesa për punë nga personat me aftësi të kufizuara ka mbetur në të njëjtat nivele.

Ka një rritje absolutisht të lartë të numrit të grave kryefamiljare në kërkim të një pune (nga 99 në 480) dhe ato zënë 78% të numrit të grave të rregjistruara aktualisht për punë.

Ka rënie të romëve të rregjistruar për punë, si dhe rënie të numrit të emigrantëve të rregjistruar në zyrën e punës.

Numri i punëkërkuesve femra është tashmë më i lartë se i meshkujve, sikurse grupmoshat mbi 40 vjeç përbëjnë tashmë 42% të punëkërkuesve në Zyrat e Punës, ndërkohë që në 2019 ata përbënin 57% të punëkërkuesve të rregjistruar.

Të dhënat tregojnë gjithashtu se mungesa e një profesioni lidhet drejtpërdrejtë me pamundësinë për tu integruar në tregun e punës dhe kjo duhet të shoqërohet me masa që nxisin formim profesional për grupet e përjashtuara aktualisht nga tregu. Nuk ka qendra formimi profesional publike ne Tropojë. Një organizatë joqeveritare mundëson kurse profesionale.

Niveli shumë i ulët i rregjistrimit të personave me aftësi të kufizuara mund të vijë nga faktorë të ndryshëm, si nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e punëdhënësve, mungesën e profesionit, ashtu dhe nga mungesa e ndërgjegjësimit të personave me aftësi të kufizuara, si dhe e informimit të tyre për të përfituar nga parashikimi ligjor se përfshirja në tregun e punës nuk u heq atyre mundësinë e vijimit të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Zyra e Punës zbaton këto programe aktualisht: Formim në punë; Praktika Profesionale; Punësim; Pune në komunitet.

Bashkia po ndërvepron me Zyrën e Punës duke përgatitur skeda për punësimin e individëve përfitues të ndihmës ekonomike. Në fakt sipas të dhënave të kësaj Zyre gjatë vitit 2024 nga 108 persona të punësuar 56 persona janë nga familje përfituese të ndihmës ekonomike.

***Strehimi***

Bashkia Tropojë zbaton tre programe për strehimin social: banesa sociale (15 familje përfituese), bonus qeraje (85 familje përfituese) dhe banesa me kosto të ulët (25 familje përfituese),Rikonstruksion te banesave ne kushte jot e mira jane 11 familje

Nga 27 familje përfituese të ndihmës ekonomike të rregjistruara në Bashki për të përfituar nga programet e strehimit social 10 janë përfituese të këtyre programeve.

### 1.2.2 Persona me aftësi të kufizuara

#### Madhësia dhe karakteristikat e grupit të personave me aftësi të kufizuar

Në vitin 2024 sipas të dhënave të Bashkisë 2,8 % e popullsisë përfitonin nga programi i pagesave cash të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar. Kalimi në modelin e vlerësimit biopsikosocial është shoqëruar me një rënie të lehtë në numrin e personave me aftësi ë kufizuara fizike ose mendore. Ndër tre grupet e aftësisë së kufizuar grupi më i madh është i personave me probleme të shëndetit fizik/mendor. Ata përbëjnë 86% të personave me aftësi të kufizuar në këtë Bashki.

28% e personave me aftësi të kufizuara banojnë në njësinë administrative Bajram Curri, 20% e tyre banojnë në njësinë administrative Tropojë dhe në 6 njësitë e tjera administrative përqindja e PAK shkon nga 6%-11%.

17% e PAK në Bashkinë Tropojë janë të grup moshës 0-18 vjeç. Numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara e kemi në njësitë administrative Bajram Curri, Bujan dhe Tropojë.

Janë 855 invalidë pune në Bashkinë Tropojë të cilët përveç pensionit të invaliditetit përfitojnë edhe një pagesë nga programi i mbrojtjes sociale.

Shërbimet reabilituese dhe zhvilluese për fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të konsiderohen me prioritet, si një mundësi për të lehtësuar dhe përmirësuar integrimin e tyre në moshë madhore. Njësitë administrative Bajram Curri, Bujan dhe Tropojë kanë numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara që kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për pasojë kanë një ndihmës (kujdestar) që kujdeset për ta duhet të mbështeten gjithashtu me shërbime alternative që mbështesin jo vetëm personin me aftësi të kufizuar, por edhe personin që kujdeset për të.

86% e personave me aftësi të kufizuara kanë probleme të shëndetit fizik/mendor. Mes tyre në mënyrë të veçantë duhen prioritizuar shërbimet per personat me probleme të shëndetit mendor.

#### Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara

Vlerësimi bio-psiko-social bën të mundur përcaktimin e shkallës së prekjes së aftësisë për të realizuar, veprimtaritë bazë e ato të jetës së përditshme (që përfshin edhe aftësinë për punë) të grupuar në nivelet e lehtë (5-24%), e moderuar (25-49%), e rëndë (50-95%) dhe e thellë apo e plotë (96-100%). Kjo lejon përcaktimin objektiv të nivelit të aftësisë së kufizuar, si edhe nevojat për shërbime të tjera si ndihmësi personal, paketa higjeno-sanitare, përkthyesi i gjuhës së shenjave, mjetet ndihmëse për lëvizje, etj. Pjesë e vlerësimit janë intervistat nëpërmjet të cilave komisioni bën

vlerësimin për të krijuar profili bio-psiko-social i përfituesit të aftësisë së kufizuar e më pas bën rekomandimet përkatëse në lidhje me përfitimet në pagesa dhe shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, të arsimit, të formimit profesional dhe punësimit, strukturën familjare të personave me aftësi të kufizuara etj. Tashmë në vendimin e komisionit për personin me aftësi të kufizuar kombinohet vendimi për përfitimin e pagesës së përmuajshme për aftësinë e kufizuar me cilësimin e shërbimeve që duhet të marrë individi në përputhje me nevojat e vlerësuara.

Komisionimi i personave me aftësi të kufizuara tashmë kryhet në Bajram Curri që ka lehtësuar barrën financiare të tyre dhe jo vetëm.

Fokus grupet me administratorët shoqërorë theksuan se ky model i ri vlerësimi është shoqëruar me dy sfida:

- Së pari kriteret e reja të vlerësimit kanë nxjerrë jashtë sistemit të pagesave cash një numër individësh për të cilët janë parashikuar vetëm përfitim shërbimesh.
- Së dyti mungesa e shumë shërbimeve apo barriera që krijohen shpesh për aksesin tek shërbimet egzistuese (sic është disatanca nga shërbimi, mospërmbushja e kritereve të aksesueshmërisë në përgjithësi) i bëjnë një pjesë të konsiderueshme të këtyre vendimeve të pazbatueshme.

***Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale***
Nuk egziston asnjë formë shërbimi i kujdesit shoqëror për personat me aftësi të në territorin e Bashkisë.

***Shërbimi shëndetësor***
Shërbimi shëndetësor është i shtrirë në të gjithë territorin. Specifikisht në Bashkinë Tropojë ka 8 qendra shëndetësore dhe 41 ambulanca dhe në total numri i personelit mjek në sistemin shëndetësor në Bashki është 11 punonjës. Në Bajram Curri ka gjithashtu një spital me 108 shtretër dhe personel 81 mjek e infermierë. Ka mungesa të specialistëve mjek për diagnoza të ndryshme, për të marrë recetat për ilaçet e rimbursueshme PAK duhet të shkojnë në Kukës ose Tiranë.

***Shërbimi i punësimit***
Niveli i rregjistrimit për punësim i personave me aftësi të kufizuara vijon të mbetet i ulët.

Bashkia përgatit skeda për punësimin e personave me forma të lehta të aftësisë së kufizuar dhe ja përcjell Zyrës së Punës. Nuk ka raste të punësimit të tyre nga Zyra e Punës.

Bashkia ka punësuar në strukturat e saj persona me aftësi të kufizuara

***Shërbimi i strehimit social***
Mungojnë të dhënat nga struktura e strehimit mbi numrin e aplikimeve nga familje që kanë persona me aftësi të kufizuara dhe të përfituesve nga programet e strehimit

***Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim***

Mungesa e të dhënave nga strukturat e arsimit e bën të pamundur analizën e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim dhe mbështetjes nga mësuesit ndihmës.

### 1.2.3 Viktima të dhunës në familje

**Madhësia e grupit, karakteristikat dhe MKR**

Ka një tendencë rritëse të raportimit të rasteve të dhunës në familje, kjo edhe për shkak të fushatave disavjeçare kundër dhunës dhe ngritjes së mekanizmit për ta adresuar këtë çështje. 6 raste të dhunës në familje u rregjistruan gjatë vitit 2018 në Bashkinë Tropojë, për të cilat ishin dhënë 3 urdhëra të menjëhershëm mbrojtje. Gjatë vitit 2024 u trajtuan vetëm 21 raste dhunë në familje. Në vitin 2024 strukturat e policisë dhe Koordinatorja Vendore për masa kundër dhunës në familje raportuan 12 raste të viktimave të dhunës në familje për të cilat ishte dhënë Urdhër Mbrojtje. Dhuna në familje prek më së shumti gratë dhe fëmijët si dëshmitar të dhunës që ushtrohet ndaj nënës së tyre.

Në Bashkinë Tropojë një punonjës social punon edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve edhe ato të masave kundër dhunës në familje. Në njësitë adminsitrative mungojnë punonjësit social për menaxhimin e rasteve sociale, përfshirë ato të dhunës. Bashkia ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucioneve të ndryshme në përputhje me detyrimin ligjor dhe Komiteti Drejtues mblidhet një herë në tre muaj. Ka një përmirësim të qasjes ndërsektoriale të menaxhimit të rasteve të dhunës dhe rritje të ndërgjegjësimit të institucioneve lokale për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore. Grupet teknike mblidhen me kërkesën e koordinatores vendore në Bashkinë Tropojë, por mungesa e shërbimeve sociale e bën sfidues menaxhimin e rastit.

Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të sektorit të ndihmës ekonomike dhe PAK, mungesa e punonjësve socialë në njësitë administrative që kufizon mundësinë e identifikimit proaktiv të rasteve dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me aktorë publik e jopublik që kanë detyrime ligjore në këndvështrimin e masave kundër dhunës në familje, vështirëson si identifikimin e rasteve ashtu edhe mbështetjen e tyre në vijim.

**Shërbimet për viktimat e dhunës në familje**

***Shërbimet sociale***

Nuk egziston asnjë shërbim kujdesi shoqëror për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Tropojë. Rastet menaxhohen nga e vetmja punonjëse e sektorit që trajton edhe rastet e mbrojtjes se fëmijës në ndërveprim me grupin teknik ndërsektorial. Mungesa e transportit e bën të vështirë monitorimin e situatës së viktimës së dhunës në familje gjatë periudhës së vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes. Kjo e detyron stafin e Bashkisë që të monitorojë vetëm rastet me rrezik të lartë. Ndihma ekonomike i mundësohet në kohë çdo viktime të dhunës sipas ligjit.

***Strehimi social***

Bashkia ka programe të strehimit social. Koordinatorja vendore për masa kundër dhunës në familje specifikon se tre viktima të dhunës gjatë vitit 2023 kanë përfituar nga programi i strehimit social të Bashkisë.

***Punësimi***

Gjatë vitit 2024 raportohen gjashte raste që kanë përfituar kurs formimi profesional dhe punësim.

***Shërbim mbështetës për fëmijët***

Pese raste gjatë vitit 2024 kanë përfituar shërbim mbështetës për fëmijët kryesisht përmes përfshirjes në çerdhë/kopshte pa pagesë nga Bashkia.

### 1.2.4 Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Nëse krahasojmë të dhënat e rasteve të menaxhuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje të vitit 2020 me vitin 2024 shohim se është ruajtur pothuajse i njëjti nivel rastesh (në 2020 janë menaxhuar 17 raste dhe në 2024 janë menaxhuar 19 raste). Mes fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje vijon të mbeten në përqindje më të lartë fëmijët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (94% e këtij grupi) , si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (5,3% e grupit). Programi i pagesave cash për ta apo familjet e tyre është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre për zhvillim dhe integrim njësoj si bashkëmoshatarët e tyre, prandaj duhet të egzistojnë shërbimet specifike të kujdesit shoqëror të ndërtuara sipas nevojave të secilit grup mes fëmijëve. Ka fëmijë në rrezik trafikimi, kryesisht fëmijë të komunitetit rom.

Mungesa e burimeve njerëzore në territorin e çdo njësie administrative reflektohet edhe tek ky grup i identifikuar në nevojë për shërbime mbrojtje apo përkujdesi social. Numri i ulët i rasteve të menaxhuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje mund të jetë i lidhur edhe me mungesën aktuale të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve në territorin e njësive administrative, që kufizon mundësinë e identifikimit proaktiv të rasteve dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me aktorë publik e jopublik që kanë detyrime ligjore në këndvështrimin e garantimit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Diskutimet mes institucioneve të ndryshme në tryezat e zhvilluara në funksion të përgatitjes së këtij plani theksuan se ka një rritje të ndërveprimit mes tyre për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki (edhe pse punon edhe për koordinimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje) ndërvepron me psikologët e shkollave, policinë dhe strukturat e shëndetësisë.

Institucionet ndërveprojnë edhe për ndërmarrjen e fushatave të ndërgjegjësimit.

**Shërbimet për fëmijët**

Sfidë mbetet mungesa e çdo lloj shërbimi kujdesi shoqëror për fëmijët në territorin e Bashkisë Tropojë.

Çdo rast i fëmijëve në nevojë për mbrojtje menaxhohet nga i vetmi Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki (që kryen edhe detyrën e koordinatorit për masa kundër dhunës në familje, si dhe të specialistit të strehimit), në ndërveprim me grupet teknike ndërsektoriale.

Shërbimi i kujdesit alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror gjithashtu nuk është i ngritur, por rastet emergjente apo zgjidhjet me afatgjata janë menaxhuar me mbështetjen e personave me lidhje gjaku me fëmijën. Mungesa e burimeve njerëzore e bën të pamundur monitorimin nga ana e Bashkisë të jetesës së tyre në familjet kujdestare.

### 1.2.5 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

Mungojnë të dhëna satistikore të mbledhura në mënyrë të vazhdueshme mbi nevojat për shërbime për të moshuarit, gjë që e vështirëson të kuptuarin e nevojave për këtë target-grup. Sikurse edhe në rastin e dhunës në familje apo mbrojtjes së fëmijëve mungesa e punonjësve social që punojnë për identifikimin, menaxhimin dhe referimin tek shërbimet sjell për pasojë edhe mungesën e informimit të komunitetit se ku dhe si të kërkojnë mbështetje, edhe identifikimin e rasteve nga vetë strukturat e Bashkisë.

Sipas të dhënave të gjendjes civile janë 3,141 të moshuar në territorin e Bashkisë Tropojë. Nga tryeza e zhvilluar për identifikimin e nevojave për shërbime në këtë Bashki u theksua se ka një tendencë në rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm dhe në kushte të vështira ekonomike. Një pjesë e tyre edhe pse janë në vështirësi nuk përfitojnë ndihmën ekonomike. U theksua gjithashtu në tryezë se ka ardhur në rritje edhe nevoja për asistencë shtëpiake, por bashkia nuk ofron asnjë formë shërbimi social për këtë grup.

### 1.2.6 Personat me varësi nga droga dhe alkooli

Edhe për këtë grup nuk ka të dhëna të sakta për madhësinë e tij, por tryeza e zhvilluar për të identifikuar nevojat për shërbime vlerësoi se ky është një nga grupet që jo vetëm egziston, por që po rritet. Përfaqësues të strukturave të shëndetësisë në tryezë theksuan se janë të paktën 20 përdorues që marrin trajtim nga strukturat shëndetësore për varësinë nga droga kryesisht të grupmoshës 20-30 vjeç.

Personat me varësi nga alkooli raportohen nga strukturat e shëndetësisë, rreth 40-60 raste. Ka një tendencë në rritje që personat me varësi nga alkooli të braktisen nëpër spitale nga familjarët e tyre. Në mungesë të shërbimeve sociale strukturat e shëndetësisë nuk mund të adresojnë këtë problematikë të braktisjes së këtyre individëve.

# 2. KAPACITETET E BASHKISË

## 2.1 Burimet njerëzore

Dy komponentë kyç u analizuan në këndvështrimin sasior dhe cilësor të burimeve njerëzore të domosdoshme për funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë: (1) struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë; (2) Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (njësia administrative);

### *(1) Struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë;*

Në përputhje me Rregulloren e Bashkisë Tropojë, struktura përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror është Sektori i Ndihmës ekonomike dhe PAK, pjesë e Drejtorisë Ekonomike. Sektori përbëhet nga:

1. Përgjegjëse e Sektorit të ndihmës ekonomike dhe PAK
2. Administrator NE
3. Administrator PAK
4. Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave të dhunuara

Nenet 49-52 të Rregullores specifikojnë detyrat për katër pozicionet e punës së lartpërmendura. Nga analiza e detyrave funksionale rezulton se:

Sektori ka për mision ofrimin e ndihmës shoqërore dhe shërbimeve sociale individëve me status të veçantë dhe familjeve në nevojë.

1. ***Përgjegjësi i sektorit*** në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror është i ngarkuar me detyrën e ofrimit të tërësisë së shërbimeve individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë me burimet e veta nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike. (i) hartues i politikave për kujdesin social, mbledh dhe analizon informacionin mbi situatën sociale të shtresave në nevojë dhe kategorive në risk (ii) kryerjen e identifikimit dhe verifikimin e rasteve sociale dhe referimin tek shërbimet përkatëse[5].

2. ***Administratori i ndihmës ekonomike***, në përputhje me nenin 50 të Rregullores ka përgjegjësi (i) për mirëadministrimin e programeve të mbrojtjes sociale (pagesat cash NE) dhe (ii) për përmbushjen e procedurave për shërbimin e kujdestarisë për fëmijët pa kujdes prindëror të përkohshëm (vlerësim i familjeve aplikuese si familje kujdestare, përcjellje dokumentacioni tek Komisioni multidisiplinor, depozitim i kërkesës në Gjykatë); (iii) procedurat e kërkesës për shërbime.

3. ***Administrator PAK,*** në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Bashkisë Tropojë detyrat e këtij punonjësi lidhen me pranimin e dokumentacionit për

[5] Rregullore e Bashkisë Tropojë, Neni 49 faqe 36 aksesuar ne https://tropoje.gov.al/storage/2018/03/Rregullore-p%C3%ABr-Organizimin-dhe-Funksionimin-e-administrat%C3%ABs-s%C3%AB-Bashkis%C3%AB-Tropoj%C3%AB.pdf

njohjen e të drejtës së përfitimin të pagesave të PAK, përllogaritjen e masës së përfitimit për secilin përfitues, sikurse dhe programimin e fondeve të PAK.

4. ***Punonjësi social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave të dhunuara***, në përputhje me nenin 52 të Rregullores kryhen detyra të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe rasteve të fëmijëve në nevojë në mbrojtje, si dhe masave për informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit. Në bazë të intervistës së zhvilluar rezulton se përveç këtyre detyrave që i ngarkon Rregullorja punonjësja sociale trajton dhe çështjet e strehimit duke ndërvepruar si me përgjegjësen e sektorit, ashtu edhe me administratorët shoqëror.

***(2) Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (njësia administrative)***

Këto njësi jo vetëm nuk janë ngritur, por edhe përshkrimi i punës së administratorit shoqëror nuk reflekton ndryshimet ligjore që kanë ndodhur pas vitit 2016.

***Administratori i Ndihmës shoqërore dhe PAK në njësitë administrative në përputhje me*** nenin 53[6] kryen detyra që lidhen me dy fusha: 1. Mbrojtja sociale (aplikimi për ndihmë ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar); 2. Shërbimet e kujdesit shoqëror: duke kryer rolin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë në mbrojtje dhe detyra që lidhen me shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.

***Sfidat e identifikuara***

***Mungesa e personelit të dedikuar për çështjet e planifikimit, ngritjes dhe funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror,*** sikurse ngarkesa e punës për koordinimin dhe administrimin e programit të pagesave cash e bën të pamundur që me organizimin aktual ky sektor të përmbushi funksionet që duhet të ketë sipas ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror. Nga intervista e zhvilluara me përgjegjësen e sektorit rezulton që në praktikë puna e sektorit konsiston më së shumti në mirëadministrimin e programit të pagesave cash (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar). Numri i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike është shumë i lartë, sikurse dhe numri i individëve me PAK dhe në këto kushte është e pamundur që kjo strukturë të angazhohet për procese të planifikimit dhe ngritjes së shërbimeve.

***Mungesa e stafit të dedikuar për menaxhimin e rasteve sociale***. Me përjashtim të punonjëses sociale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave të dhunuara që menaxhon rastet e fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje, asnjë punonjës tjetër nuk ka detyrë funksionale menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

***Mungesa e shërbimeve*** e bën akoma më sfiduese punën për menaxhimin e rasteve. Programi i pagesave kesh dhe masat për strehimin social janë të vetmet rrugë që stafi ka në dispozicion për të mbështetur individët në nevojë.

***Nevojat për trainime.*** Legjislacioni në tërësi në këtë fushë është i ri dhe gjerësisht personeli shprehu nevojën për të marrë trainime sipas fushës së përgjegjësisë që ata kanë.

## 2.2 Fondi Social

Struktura përgjegjëse në Bashki thekson se mungesa e burimeve njerëzore dhe eksperienca në shkrimin e projekteve ka frenuar mundësinë e thithjes së fondeve për të bërë të zbatueshëm Planin Social të Bashkisë. Bashkia nuk ka alokuar fonde nga të ardhurat e saj, edhe pse të limituara, për të financuar qoftë edhe ndonjë komponent të vetëm të atij Plani.

# 3. ANALIZA SWOT

### Pikat e forta

- ✓ Kërkesa për shërbime sociale është çështje emergjente sepse shërbimet mungojnë tërësisht.
- ✓ Struktura aktuale e Shërbimeve Sociale është e motivuar për të ngritur dhe siguruar shërbime sociale për grupet më në nevojë kritike.
- ✓ Është përmirësuar ndjeshëm bashkëpunimi ndërinstitucional në diskutimin dhe adresimin e nevojave të disa prej grupeve të identifikuara në nevojë në territorin e Bashkisë.

### Pika të dobëta

- ✓ Mungesa e burimeve njerëzore të nevojshme për të ngritur dhe mbajtur sistemin e shërbimeve shoqërore funksional.
- ✓ Mungesa e mbështetjes financiare, kryesisht për shkak të mungesës së Fondit Social.
- ✓ Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- ✓ Kapacitete të kufizuara të Bashkisë për shkrim projekti dhe për aplikim për fonde.
- ✓ Numër abosulitisht i ulët i organizatave që punojnë në territor në këtë fushë.

### Mundësitë:

- ✓ Reforma e Qeverisjes Vendore.
- ✓ Decentralizimi i shërbimi i sociale.

- ✓ Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.

**Rreziqe**

- ✓ Mos alokimi i burimeve njerëzorë dhe financiare të nevojshme për ta bërë planin të zbatueshëm.
- ✓ Vijimi i pasivitetit në aplikimet për projekte, thithje fondesh me qëllim ngritjen e Fondit Social.

## 4. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

### 4.1 Misioni

Bashkia Tropojë do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

### 4.2 Vizioni

Grupet dhe individët e përjashtuar apo në rrezik përjashtimi në Bashkinë Tropojë kanë akses dhe përdorin shërbime shoqërore në përputhje me nevojat e tyre, që iu mundësojnë jetesën dhe kontributin me dinjitet, të përfshirë dhe jo të diskriminuar, duke realizuar potencialin e tyre, në një shoqëri që i mbështet të ruajnë aftësitë funksionale e shoqërore.

### 4.3 Parimet udhërrëfyese

Bashkia Tropojë udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;

Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të interesit, përgjatë procesit të hartimit të planit, si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;

Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;

Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të interesit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;

Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.

Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;

Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;

Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.

Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

## 5. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Në grafik prezantohen tre ndërhyrjet kyç që do të zbatohen në këtë Plan për të përmbushur misionin dhe vizionin e Bashkisë Tropojë për shërbimet sociale në periudhën 2025-2027. Veprimet konkrete që do të ndërmerren shtjellohen në mënyrë të detajuar në vijim.

**Qëllimi 1. Zhvillimi i kapaciteteve të Bashkisë për të ngritur dhe zhvilluar sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror**

- Sektori i NE dhe shërbimit social i fuqizuar;
- NJVNR e ngritur dhe funksionale;

**Qëllimi 2. Zhvillim dhe zgjerim i mekanizmave ndërsektorial për identifikim dhe adresim efektiv të nevojave të grupeve vulnerabël**

- Mekanizmat ndërsektorial rritin reagimin ndaj nevojave të grupeve vulnerabël;
- Komuniteti lokal i Informuar per sistemin e shërbimeve dhe si ti aksesoj ato;
- Raste të menaxhuara nga NJVNR;

**Qëllimi 3. Ngritje e shportës minimale të shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë për të përfshirë e adresuar nevojat e grupeve të targetuara**

- Informim e këshillim për çdo individ;
- Shërbim ditor: PAK, të moshuar, fëmijë;
- Shërbim psikologjik;
- Këshillim viktima të dhunës në familje dhe fëmijë;
- shërbim emergjence viktima dhune, fëmijë, indivdë në risk të lartë;
- Shërbim në familje: të moshuar, PAK;


United Nations Development Programme
United Nations House
"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

## Qëllimi 1. Zhvillimi i kapaciteteve të Bashkisë për të ngritur dhe zhvilluar sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

***Objektivi 1. Brenda vitit 2025 strukturat përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin shoqëror do të kenë burimet njerëzore dhe financiare për të përmbushur detyrat funksionale sipas përcaktimeve të legjislacionit kombëtar***

### 1.1.1 Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki

Sektori do të përmbushë këto funksione:
- Koordinimi dhe drejtimi i zbatimit të programeve të pagesave cash NE dhe PAK për të gjithë territorin e Bashkisë.
- Planifikimi, ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin komunitar.
- Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët.
- Barazia gjinore dhe masa kundër dhunës në familje

Struktura dhe detyrat për çdo pozicion pune do të përfshihen në Rregulloren e Bashkisë Tropojë.

Në përbërje te sektorit do të jenë:
- Përgjegjës i sektorit
- Specialist i mbrojtjes dhe përkujdesit social (1 punonjës)
- Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës (1 punonjës)
- Koordinatori për masa kundër dhunës në familje (1 punonjës)
- Koordinatori për fuqizimin ekonomik (1 punonjës)

Në varësi të këtij Sektori do të jetë Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe Qendra Multifunksionale Komunitare.

### 1.1.2 Ngritja e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Në kushtet që bashkia Tropojë ka buxhet të kufizuar për të përballuar gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani një rritje të personelit me të gjithë punonjësit që kërkon ligji 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit Shqoëror" dhe ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijës", do të ngrihet një Njësi e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit me qëllim përmbushjen e të gjitha funksioneve që parashikon legjislacioni kombëtar.
Kjo Njësi do të përbëhet nga:
- Administrator shoqëror (8 punonjës)
- Punonjës social (1 punonjës)

Kjo njësi sikurse e parashikon edhe legjislacioni kombëtar do të jetë një hallkë lidhëse mes komunitetit në çdo njësi administrative dhe strukturës përgjegjëse për mbrojtjen dhe përkujdesin social në Bashki. Ajo do të jetë vija e parë e shërbimit, pasi çdo individ në nevojë për shërbime do ti drejtohet ose referohet tek kjo njësi.

Administratorët shoqërorë (një administrator për çdo njësi administrative dhe për qytetin) do të vijojnë të mundësojnë (i) shërbimin e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike; (ii) verifikimin në familje të situatës së aplikantëve; (iii) Përgatitjen e planit individual për punësim të individëve në moshë pune dhe referimin tek shërbimi i punësimit; (iv) informim dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara; (v) viziat në familje çdo tre muaj: (vi) referimin tek shërbimet e përcaktuara nga Komisioni i Vlerësimit Bio-psiko-social.

Punonjësi social do të jetë menaxher i çdo rasti të referuar në nevojë për shërbime nga territori i çdo njësie administrative. Veçanërisht në vitin e parë ai do të jetë përgjegjës për të zbatuar planin për identifikimin e individëve në nevojë për shërbime, sikurse do të ndërveprojë me administratorët shoqërorë, PMF dhe koordinatorin për masa kundër dhunës në familje (këta të fundit pjesë e strutkurës së Sektorit në Bashki) për të menaxhuar rastet në territorin e bashkisë.

### 1.1.3 Trainime të stafit të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Trainimet do të ndërtohen në përputhje me nevojat e personelit të të dy niveleve të organizimit (Sektori dhe NJVNR), si dhe të funksioneve që duhet të përmbushin këto struktura.

Trainimet për personelin e Sektorit të Ndihmës ekonomike dhe Shërbimit Social do të fokusohen të paktën në këto çështje:

- Planifikimi strategjik dhe buxhetimi i sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Mekanizmi i financimit të shërbimeve dhe teknika të shkrimit të projekteve sociale.
- Standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, prokurimi dhe monitorimi i shërbimeve.

Trainimet për personelin e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të përfshijnë të paktën:

- Njohuri të thelluara mbi paketën legjislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël;
- Teknika të punës në ekip dhe menaxhimit të rasteve sociale.
- Trainime specifike për çështje të mbrojtjes së fëmijës, viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit, si dhe këshillimi për punësim.

### 1.1.4 Krijimi i modeleve dhe praktikave të punës të NJVNR

Stafi i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social brenda gjashtëmujorit të parë të zbatimit të këtij plani do të përgatisë dhe do të udhëzojë stafin e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit mbi protokollet e punës për menaxhimin e rasteve. Në mënyrë të veçantë: paketën me të gjithë formularët për identifikimin dhe raportimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, fëmijëve në nevojë për


United Nations Development Programme
United Nations House
"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

mbrojtje, viktimave të dhunës, si dhe çdo tip formulari të përcaktuar në legjislacion dhe akte nënligjore, si dhe aksesi dhe hedhja e të dhënave në Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale,.

### 1.1.5 Analiza dhe rishikimi periodik i Planit Social

Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social brenda vitit të parë të zbatimit të Planit do të analizojë në periudhën tetor-nëntor të çdo viti nivelin e përmbushjes së aktiviteteve të parashikuar në Planin Social, si dhe cilësinë e zbatimit të tyre. Mbi këtë bazë do të realizojë rishikimin e përvitshëm të Planit Social të Bashkisë. Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të zhvilloj çdo vit dëgjesa me secilin prej grupeve të identifikuara në nevojë për shërbime. Dëgjesa do të zhvillohen veçanërisht me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, romët dhe egjiptianët. Pas ngritjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan, kjo strukturë si pjesë e procesit të monitorimit të cilësisë së shërbimeve do të zhvilloj intervista/fokus grupe me përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre shërbimeve.




**Qëllimi 2. Zhvillim dhe zgjerim i mekanizmave ndërsektorial për identifikim dhe adresim efektiv të nevojave të grupeve vulnerabël**

***Objektivi 1: Zgjerim i mekanizmit dhe ndëveprimit për të mundësuar riintegrim ekonomik e social të individëve në situatë vulnerabël***

### 2.1.1 Mekanizmi për fuqizimin dhe riintegrimin ekonomik e social

Koordinatori për fuqizimin ekonomik në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për taksat do të ndërtojë bazën e të dhënave të bizneseve që kanë potenciale punësimi në të gjithë territorin e Bashkisë. Në përfundim të këtij procesi Bashkia do të thëras në një tryezë të gjithë drejtuesit e bizneseve, përfaqësues të Zyrës së Punës, Formimit Profesional, Agjensisë së Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale, si dhe organizata joqeveritare të identifikuara që zhvillojnë projekte të fuqizimit ekonomik. Tryeza do të synojë: (i) të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve që kanë kapacitete për punësim për nevojën e përfshirjes në tregun e punës së individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe në mënyrë të veçantë grave kryefamiljare, viktimave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara; (ii) të diskutohen forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-AZHB- Formimit profesional (organizata) me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve me ndihmë ekonomike. Mbi bazën e konkluzioneve të tryezës koordinatori për fuqizimin ekonomik do të ndërtoj një Plan-Veprimi mes aktorësh me target punësimin e familjeve dhe individëve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe grupeve prioritare për punësim. Masat e këtij Plani do të përforcojnë masat e parashikuara në Planin Social që do të ndërmarrë vetë Bashkia Tropojë në funksion të fuqizimit ekonomik. Në secilin nga dy vitet pasuese të këtij Plani kjo tryezë do të rimblidhet për të diskutuar mbi rezultatet, sfidat dhe përmirësimet e mundshme.

### 2.1.2 Këshillim dhe punësim

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të bashkëpunojë me specialistët e Zyrës së Punës për të përgatitur skedat për punësim, por edhe për të ndërgjegjësuar çdo individ në vështirësi ekonomike mbi domosdoshmërinë e pranimit të ofertës së punës. Në fund të çdo viti Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, NJVNR dhe Zyra e Punës do të diskutojnë në një tryezë pune mbi arritjet dhe sfidat e punësimit gjatë vitit specifik dhe do të planifikojnë masat për vitin pasues.

### 2.1.3 Angazhim i Bashkisë për fuqizimin ekonomik

Koordinatori për fuqizimin ekonomik do të ndërveprojë me drejtorinë e burimeve njerëzore, si dhe me drejtoritë e Bashkisë që menaxhojnë kontrata publike për të mundësuar punësimin e individëve nga grupet prioritare të këtij plani (gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuara, viktima të dhunës në familje). Target: të paktën 10 individë nga këto grupe do të jenë të punësuar çdo vit.

***Objektivi 2. Ngritje e mekanizmit të koordinuar për adresimin efektiv të nevojave të personave me aftësi të kufizuara***

### 2.2.1 Ngritja dhe funksionimi i mekanizimit

Pjesë e këtij mekanizmi do të jenë strukturat e: arsimit, shëndetësisë, zyrës të punës. Së bashku me Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe shërbuimeve sociale këto tre institucione do të punojnë në partneritet si në këndvështrimin e shkëmbimit të informacionit, referimin, si dhe ofrimin e shërbimit përgjatë menaxhimit të rasteve sociale. Në muajt e parë të zbatimit të Planit Social Sektori i ndihmës ekonomike dhe

shërbimit social do të thërasë një tryezë me përfaqësues të tre institucioneve, si dhe çdo organizate që punon në këtë fushë. Në tryezë do të përcaktohen format e bashkëpunimit, si dhe do të specifikohet rrjeti i specialistëve nga secili institucion që do të angazhohet në vijim.Tryeza do të mblidhet dy herë në vit për të analizuar arritjet, diskutuar sfidat dhe parashikuar masat në vijim.

### 2.2.2 Identifikimi i rasteve në nevojë për shërbime

Shkëmbimi i informacionit mes strukturave të Bashkisë, të arsimit dhe shendetësisë do të synojë të mundësojë identifikimin e çdo individi që ka të nevojshëm si përfshirjen në sistemin e pagesave, ashtu dhe individët që kanë të nevojshme përfshirjen në shkollë apo marrjen e shërbimeve të reabilitimin dhe zhvillimit. Në mënyrë të veçantë do të synohet identifikimi i rasteve të fëmijëve që kanë të nevojshëm ndërhyrjen e hershme, fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuar apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj. Synimi do të jetë që fëmijës ti ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare sipas nevojave te veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) ne mjedisin ku fëmija ushtron aktivitetin e përditshëm (në kopësht, shkollë apo qendrën ditore). Ndërveprimi me sistemin arsimor lokal do të jetë prioritet për të mundësuar këtë formë shërbimi. Ndërveprimi me Zyrën e Punës do të synojë rritjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

### 2.2.3 Rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedisin publik dhe në shërbime

Bashkia Tropojë brenda vitit të dytë të zbatimit të Planit Social do të ngrejë një grup pune miks me përfaqësues nga Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social dhe drejtorive të linjës në këtë Bashki (transport, urbanistikë, financë), i cili do të punojë për të identifikuar barrierat egzistuese me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara në mjedisin fizik, në transport dhe marrjen e shërbimeve brenda përgjegjësisë së Bashkisë. Grupi do të hartojë një raport me rekomandime për eleminimin e këtyre barrierave.

***Objektivi 3. Ngritje dhe funksionim i mekanizmit për veprim të koordinuar për adresimin e nevojave të të moshuarve***

### 2.3.1. Ngritja e strukturave koordinuese për mbështetjen e të moshuarve

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të krijojë partneritetin me strukturat shëndetësore për të identifikuar vendndodhjen dhe nevojat e të moshuarve të sëmurë në nevojë për asistencë sociale dhe do të shkëmbej informacion me ta në funksion të këtyre nevojave. Si hap i parë Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të mbledhë në një tryezë përfaqësues të shëndetësisë dhe do të diskutojë format e bashkëpunimit dhe rrugët ëpr shkëmbim informacioni. Në vijim të tryezës çdo e dhënë e strukturave shëndetësore do të përcillet pranë Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku ka vendbanimin çdo i moshuar në nevojë për shërbim me qëllim vlerësim më të thelluar të nevojës dhe referimin tek shërbimet specifike.

## *Objektivi 4. Ngritje e mekanizmit lokal për veprim të koordinuar për reabilitimin e përdoruesve të drogës*

### 2.4.1. Krijimi i strukturave koordinuese për identifikimin e rasteve

Aktualisht mungon një sistem i rregjistrimit të përdoruesve, si dhe referimit të tyre tek shërbimet. Për të adresuar këtë mungesë Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të krijojë partneritetin me strukturat shëndetësore dhe të policisë së pari për tu informuar prej tyre për çdo rast të përdoruesve të drogës dhe alkoolit me qëllim ndjekjen e çdo rasti nga ekipet e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Çdo e dhënë e strukturave shëndetësore apo të policisë do të përcillet pranë Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ku ka vendbanimin çdo person i identifikuar me qëllim vlerësim më të thelluar të nevojës dhe referimin tek shërbimet specifike.

## *Objektivi 5: Konsolidim i mekanizmave egzistues për identifikimin, mbrojtjen dhe reabilitimin e fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje*

### 2.5.1. Konsolidimi i punës së grupeve teknike ndërsektoriale për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të mbledhë në gjashtë mujorin e parë të zbatimit të këtij Plani grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës prezanton në takimin e parë të këtij grupi Planin e vitit të parë për ndërgjegjësimin mbi të drejtat e fëmijëve që përfshin aktivitete ndërsektoriale që do të ndërmerren për të përmbushur këtë qëllim. Grupi teknik mblidhet më pas sa herë ka raste për të menaxhuar.

### 2.5.2. Konsolidimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj

Në përputhje me VKM Nr.327 datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës", Kryetari i Bashkisë do të thërrasë në një tryezë drejtuesit e institucioneve të parashikuar në këtë VKM për të qenë pjesë e Komitetit Drejtues për parandalimin dhe masat kundër dhunës në familje. Ky Komitet do të mblidhet në mënyrë periodike për të analizuar situatën e dhunës në familje. Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje që është njëkohësisht drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor (të përbërë nga përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor), do të përgatisë për çdo mbledhje të Komitetit analiza/raportime mbi aktivitetet ndërsektoriale të ndërmarra për ndërgjegjësimin komunitar, si dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

## Objektivi 6. Identifikim dhe menaxhim efektiv i çdo rasti në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

### 2.6.1 Sistem i integruar i referimit të rastit

Synimi është që të ngrihet sistemi i integruar i referimit të rastit duke përfshirë në të çdo institucion publik, ofrues shërbimesh dhe organizata që janë të angazhuara në këtë fushë. Pjesë e këtij sistemi do të jenë edhe kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit e komunitetit. Të gjitha mekanizmat ndërsektorialë të ngritura do ti mundësojnë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social të ketë pikat e kontaktit pranë çdo institucioni dhe ofruesi shërbimesh në territor. Këto pika kontakti do të jenë të rëndësishme për Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit pasi do të shërbejnë si grupe teknike ndërsektoriale me përfaqësues të institucioneve publike dhe ofrues shërbimesh që përfshihen në territorin e njësisë përkatëse, me qëllim menaxhimin e rasteve përmes qasjes multisektoriale. Punonjësi social i NJVNR do të pajiset me një numër celulari që do të jetë publik me qëllim referimin e rasteve sociale. Sistemi i ngritur do të publikohet në ambjentet ku ofrohen shërbime nga Bashkia dhe aktorët e përfshirë në këtë sistem.

### 2.6.2 Menaxhim i rasteve sociale

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje do të kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes" [7]. Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social ka ngritur grupin teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie. Për menaxhimin e rasteve Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës do të koordinojë me punonjësin social të NJVNR.




Menaxhimi i rasteve të viktimave të dhunës në familje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 327 datë 2.06.2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe reabilitimin e viktimave të dhunës" [8]. Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje drejton ekipin teknik ndërdisiplinor (më përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor). Për menaxhimin e rasteve ndërvepron gjithashtu me me punonjësin social të NJVNR dhe administratorët shoqëror sipas vendbanimit të viktimës së dhunës në familje.

---

[7] *http://differentandequal.org/ëp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf*
[8] *https://shendetesia.gov.al/ëp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr.-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf*

Për çdo rast tjetër të referuar në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje menaxhimi i rastit do të kryhet nga punonjësi social i NJVNR dhe administratorët shoqëror. Për çdo rast që në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes është vlerësuar se duhet të marrë shërbime kujdesi shoqëror punonjësi social do të përgatisë dokumentacionin përkatës në përputhje me VKM nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" dhe do ta referojë tek koordinatori për shërbimet sociale në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashki. Ky i fundit në përputhje me VKM e sipërcituar do të ndërmari procedurat për miratimin e marrjes së shërbimit.

***Objektivi 7. Informim i komunitetit mbi egzistencën e sistemit komunitar të shërbimeve dhe ndërgjegjësim komunitar për të drejtat e çdo individi për të marrë shërbim***

### 2.7.1 Informim i komunitetit mbi sistemin e shërbimeve sociale

Informimi i komunitetit mbi egzistencën e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror do të jetë prioritet i cili do të mundësohet përmes takimeve të drejtpërdrejta në territorin e Bashkisë. Punonjësi social i NJVNR do të përgatisë çdo fillim viti, në konsultim me aktorët e përfshirë në grupet teknike ndërsektoriale, kalendarin e takimeve në shkolla dhe në komunitet me qëllim ndërgjegjësimin mbi shërbimet. Zbatimi do të përfshijë Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, kryetarët e fshatrave dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave pjesë e mekanizmit lokal.

### 2.7.2 Ndërgjegjësim komunitar për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje, si dhe për mbrojtjen e fëmijëve

Takimet komunitare do të planifikohen në fillim të çdo viti nga koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje dhe PMF duke koordinuar me institucionet publike që kanë përgjegjësi në këtë fushë (pjesë e mekanizmit lokal të koordinuar për të adresuar dhunën në familje dhe mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve) ofruesit e shërbimeve, si dhe organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë. Në takimin planifikues të çdo viti do të ndërtohet kalendari vjetor i takimeve komunitare, do të përcaktohet audienca, çështjet që do të prezantohen dhe roli i secilit aktor në takime. Në thelb takimet komunitare do të synojnë pjesëmarrjen e komunitetit, burra dhe gra, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të parandaluar dhe denoncuar dhunën në familje, informuar mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe informimit mbi shërbimet që egzistojnë. Takime të tilla do të targetojnë edhe shkollat në territorin e Bashkisë.

### 2.7.3 Ndërgjegjësim komunitar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

Takimet komunitare do të planifikohen në fillim të çdo viti nga Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social (koordinatori për fuqizim ekonomik) duke koordinuar me institucionet e tjera lokale (shëndetësi, arsim, organizata). Në takime do të përcaktohen çështjet që do të prezantohen në këto takime, si dhe detaje të zhvillimit të tyre. Në thelb takimet komunitare do të synojnë pjesëmarrjen e komunitetit të

personave me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre, pjesëtarë të komunitetit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe shmanigien e steriotipeve ndaj tyre. Takimet do ti shërbejnë edhe informimit të komuniteteve mbi egzistencën e shërbimeve në territor apo jashtë tij.




**Qëllimi 3. Ngritje e shportës minimale të shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë për të përfshirë e adresuar nevojat e grupeve të targetuara**

***Objektivi 1: Brenda vitit 2027 nevojat për shërbime të emergjencës, asistencës në familje, reabilituese dhe zhvilluese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror***

### 3.1.1 Informimi dhe këshillimi përmes NJVNR

Informimi dhe këshillimi do të mundësohet nga stafi i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të përgatis protokolle të unifikuara pune për:

- ✓ *Administratori i ndihmës ekomomike dhe aftësisë së kufizuar*: komponenti që i shtohet është protokolli që lidh ndihmën ekonomike me punësimin. Kjo në bazë të praktikës së re të ngritur nga ndërveprimi me Zyrën e Punës (shih Qëllimi 2, objektivi strategjik 1). *Për aftësinë e kufizuar* komponenti që i shtohet është metodologjia e punës për t'ju përgjigjur cilësisht modelit të ri të vlerësimit bio-psiko-social dhe lidhjes midis pagesës cash dhe shërbimeve. Metodologjia do të lehtësojë punën e administratorit të PAK për të realizuar pikërisht këtë lidhje.
- ✓ *Punonjësi social* – duke qenë një funksion i ri Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të përgatisë protokollin e punës së punonjësit social si menaxher i çdo rasti social në territorin e njësisë administrative. Gjithashtu punonjësi social do të jetë përgjegjës për rregjistrimin e çdo rasti në Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale.

### 3.1.2. Mundësimi i shërbimeve sociale përmes Qendrës Multifunksionale Komunitare

Qendra do të ngrihet dhe funksionojë në territorin e qytetit Bajram Curri, në përputhje me standartin kombëtar të shërbimit në qendrat multifunksionale, miratuar me Udhëzim të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale[9]. Ajo do të licensohet dhe do të përfshijë një numër shërbimesh në përputhje me prioritetet e identifikuara në këtë Plan Social. Qendra do të ofrojë një numër shërbimesh, të cilat do të ngrihen gradualisht në përputhje me prioritetin e shërbimit dhe mundësitë buxhetore të Bashkisë.

Për marrjen e shërbimit për çdo individ në nevojë do të respektohen kriteret dhe rregullat e përcaktuara në VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

*Viti i parë: Ngritje e shërbimeve ditore*

Do të ngrihen si pjesë e qendrës këto shërbime :

*Shërbimi ditor për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara*- Shërbimi do të funksionojë në përputhje me standartet e shërbimit për qendrat ditore të personave me aftësi të kufizuara[10]. Shërbimi ofrohet nga ekipi i profesionsitëve logopedist, fizioterapist, okupacionist, përveç personelit mbështetës dhe synon të nxisë zhvillimin dhe reabilitimin e personave me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeçare.

*Shërbimi ditor për të moshuarit*- Aktivitetet me të moshuarit do të planifikohen nga ekipi multidisiplinar i qendrës duke stimuluar lidhjen e aktivitetit të shërbimit ditor me jetën komunitare. Punonjësi social do të jetë përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve me të moshuarit në qendër. Shërbimi do të ngrihet në përputhje me standartin kombëtar për këtë formë shërbimi.

---

[9] Udhëzimi nr.91, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitave shumëdisiplinore"

[10] *Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar në institucionet rezidenciale dhe ditore. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ëp-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_822_06.12.20061.pdf*

*Shërbim psikologjik-* Psikologu i qendrës do të mundësojë ofrimin e: Këshillim për prindërimin (çdo prindi që është vlerësuar se ka të nevojshëm këshillimin dhe çdo rasti të fëmijëve të vendosur në familje kujdestare); Programe për menaxhimin e zemërimit për prindërit e dhunshëm; Këshillim psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje; Këshillim psikologjik për çdo viktimë të dhunës në familje, si dhe familjet që kanë përjetuar divorc;

*Shërbim ditor dhe i emergjencës për fëmijët-* Do të mundësohet shërbim për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike dhe çdo fëmijë në nevojë për shërbime sipas vlerësimit të kryer nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës. Shërbimet përfshijnë ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin. Fëmijët do të mbështeten për përgatitjen e mësimeve. Ky shërbim ngrihet në përputhje me Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore[11].

Për familjet ekstremisht të varfëra me fëmijë ngrihet shërbimi i emergjencës përmes të cilit rasteve të vlerësuara nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit u mundësohen pako ushqimore dhe higjenike si mbështetje e menjëhershme në periudhën derisa familja merr shërbime të tjera alternative.

*Shërbim në familje-* Në vitin e parë, në kushtet e mungesës së një mjeti transporti stafi i qendrës (sipas profilit të punës) do të mundësojë shërbim në familje vetëm për individët në nevojë në territorin e qytetit. Shërbimi në familje do të përfshijë (sipas nevojës) : terapi individuale; pako ushqimore (për raste specifike); këshillim.

*Viti i dytë: Vijojnë shërbimet e ngritura në vitin e parë dhe ngrihen shërbime të reja*

Në vitin e dytë stafi i qendrës zgjerohet me një punonjës social, si dhe ka një automjet të domosdoshëm për të ofruar shërbim në të gjithë territorin e Bashkisë.

Shërbimet në qendrën multifunksionale plotësohen me *:*

*Shërbime në shtëpi për persona me aftësi të kufizuara* që kanë nevojë për terapi zhvillimi dhe distanca nga qendra multifunksionale i pengon në marrjen e shërbimit. Shërbimi ngrihet në përputhje me standartin e shërbimit asistencë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara[12].

*Shërbime në shtëpi për të moshuarit* që jetojnë vetëm ngrihen në përputhje me standartin e shërbimit asistencë shtëpiake për të moshuarit[13]. Gjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani do të ngrihet shërbimi në familje për të moshuarit në zonën urbane, si hap i parë për tu pasuar pas tre vitesh me zgjerimin e këtij shërbimi në të gjithë territorin e Bashkisë. Shërbimi në shtëpi do të përfshijë (sipas nevojave të vlerësuara të individit): shërbim rehabilitimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rastit,

---

[11] *Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore. Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/54-2013.pdf*

[12] *http://ëëë.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/03/udhezim-597-dt.22.12.17.pdf*

[13] *Udhëzim 581 datë 18.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake për të moshuarit. Aksesuar në: http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/Udh%C3%ABzim_581_18.12.2017.pdf*

shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi, shërbime të kujdesit të shëndetit. Kjo formë shërbimi do të ngrihet përmes financimit në partneritet me Zyrën e Punës nga zbatimi i VKM 535, programi i punëve publike në Komunitet duke mundësuar si shërbimin për të të moshuarit, ashtu edhe punësimin e pjesëtarëve nga familje përfituese të ndihmës ekonomike.

### 3.1.3. Këshillim me telefon

Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të ndërtojë partneritetin me Linjat Kombëtare të Këshillimit specifikisht Linja Kombëtare e këshillimit për viktimat e dhunës në familje dhe Linja Kombëtare për Fëmijët. Përmes fushatave të ndërgjegjësimit do të promovohet kjo formë shërbimi veçanërisht në zonat rurale të Bashkisë.

### 3.1.4 Shërbim emergjence 72 orë dhe strehim i mbrojtur për viktimat e dhunës në familje

Nga viti i parë i zbatimit të këtij Plani një sherbim emergjence dhe një (1) apartament i mbrojtura ( marrë me qera) shërbejnë për të akomoduar rastet e viktimave të dhunës në familje të pajisura me urdhër të menjëhershëm mbrojtje. Shërbimi përfshin: Strehim, veshje (për rastet kur viktima e ka të pamundur të aksesoj edhe përkohësisht shtëpinë), ushqimin, shërbim psikologjik, shërbime mjekësore, shërbime juridike, formim profesional, punësim, mbështetje me ndihmë ekonomike, asistencë edukative/arsimore. Kjo formë shërbimi kombinohet me shërbimet që mundësohen në qendrën multifunksionale në përputhje me nevojat e vlerësuar për shërbime nga grupi teknik ndërsektorial.

### 3.1.5 Shërbimi i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror

PMF do të ndërtojë praktikën e monitorimit të situatës social-ekonomike të fëmijëve që vendosen në familje kujdestare me apo pa lidhje familjare, në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave për këtë formë shërbimi. Ndërkohë në periudhën tre-vjeçare PMF do të ndërveprojnë sistematikisht me punonjësit socialë të qendrave ku vendosen fëmijë pa kujdes prindëror nga Bashkia Tropojë dhe do të intensifikojë punën me familjet biologjike të fëmijëve me qëllim krijimin e kushteve për kthimin e tyre në familje. Vlerësimi i nevojave të çdo familje për tu fuqizuar e rimarrë fëmijën do të pasohet nga referimi dhe ndjekja e ecurisë së marrjes së shërbimeve (punësim, strehim, terapi etj) të nevojshme do të jetë prioritet i punës së PMF.

### 3.1.6 Shërbimi i strehimit social

